



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PAKR.nr.192/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Burim Ademi, kryetar, Tonka Berishaj (gjyqtare referuese) dhe Bashkim Hyseni, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Alba Makolli si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarve F.R. dhe F.O. për shkak se si bashkëkryes kanë kryer veprën penale grabitje nga neni 317 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së, O.H. për shkak të veprës penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 380 par.1 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve F.R. av. Abit Asllani dhe F.O. av. Gëzim Baloku, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.62/21 të dt.15.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK, me datë 14.06.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve F.R. dhe F.O., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.62/21 të dt.15.04.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë – departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.62/21 të dt. 15.04.2021, i ka shpallur fajtor të akuzuarit F.R. dhe F.O. për shkak se si bashkëkryes kanë kryer veprën penale grabitje nga neni 317 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së, ndërsa O.H. për shkak të veprës penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 380 par.1 të KPRK-së, ashtu që të akuzuarin F.R. e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) euro, të cilin dënim obligohet ta paguajë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, pasi aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite, e në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.09.02.2021 e tutje, të cilin dënim do ta mbajë pasi aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, nëse i akuzuari dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimin me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës. Të akuzuarin F.O. e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) euro, të cilin dënim obligohet ta paguajë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, pasi aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite, e në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim

nga dt.09.02.2021 e tutje, të cilin dënim do ta mbajë pasi aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, nëse i akuzuari dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimin me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës. Të akuzuarin O.H. e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, e në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.09.02.2021 e deri me dt.02.04.2021, të cilin dënim do ta mbajë pasi aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.

Janë obliguar të akuzuarit secili veç e veç që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Janë obliguar të akuzuarit secili veç e veç që të paguajnë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I dëmtuari B.D., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokuroria Themelore në Pejë për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që të aprovohet ankesa dhe të ndryshohet aktgjykimi, ashtu që të akuzuarve t'i shqiptohet një dënim më i lartë në përputhshmëri me rrezikshmërinë e veprës penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.R. av. Abit Asllani për shkak të sanksionit të shqiptuar, me propozim që të aprovohet ankesa dhe të ndryshohet aktgjykimi ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me burg më i butë për shkak të përgjegjësisë së zvogëluar, ose një masë e detyrueshme e trajtimit shëndetësor në liri, apo kjo masë t'i zëvendësohet me masën e tipit të mbyllur.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.O. av. Gëzim Baloku për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që aktgjykimi të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i butë me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit.

Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/I.nr.197/2021 të dt.19.05.2021 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë dhe të ndryshohet aktgjykimi, ashtu që ndaj të akuzuarve të shqiptohen dënime më të larta, ndërsa të refuzohen ankesat e mbrojtësve të akuzuarve F.R. av. Abit Asllani dhe F.O. av. Gëzim Baloku si të pabazuara.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në të cilën nuk ishin të pranishëm Prokurori i Prokurorisë së Apelit, i dëmtuari B.D., i akuzuari O.H. me mbrojtësin e tij av. Haki Mavraj, edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt për kohën dhe vendin

e mbajtjes së seancës, andaj seanca u mbajt konform nenit 390 par.4 të KPP-së. Ndërsa ishin të pranishëm i akuzuari F.R. me mbrojtësin e tij av. Abit Asllani dhe i akuzuari F.O. me mbrojtësen e tij sipas detyrës zyrtare av. Miranda Haxhiu.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorisë dhe mbrojtësve të akuzuarve së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesat nuk janë të bazuara

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtën e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë aspekt konform nenit 394 par.1 të KPPK-së dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kishin kushtëzuar prishjen e tij.

Po ashtu gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, pasi që nuk lejohet ankesa për këtë bazë ankimore sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, meqë të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës dhe me këtë është pajtuar prokurori si dhe gjykata, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve tjera ankimore.

Vendimi mbi Dënimin

Në ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë, pretendohet se gjykata e shkallës së parë me shqiptimin e sanksionit penal ka bërë tejkallim të kompetencave ligjore, për faktin se në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së ka vlerësuar të gjitha rrethanat si ato lehtësuese dhe rënduese, por përkundër kësaj ka përcaktuar dënim prej 4 viteve burg, duke mos pasur parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit për veprës penale të grabitjes, që parash dënim me gjobë dhe me burgim prej 7 (shtatë) vjet deri në 12 (dymbëdhjetë) vjet. Sipas ankesës, pikërisht neni 69 të cilit i referohet gjykata e shkallës së parë parasheh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për veprën penale. Duke marrë parasysh se gjykata në aktgjykim ka cekur se ka zbatuar dispozitat për zbutje të dënimit konform neneve 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, që i jep të drejtë të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj, apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit, prokuroria thekson se nuk është dhënë asnjë shpjegim në arsyetimin e aktgjykimin, se përse është zbutur dënimi nën kufirin ligjor, sepse është dashur të jepen arsye se cila pikë e nenit 71 të KPRK-së është zbatuar në rastin konkret. Andaj, dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve nuk do të arrij qëllimin e tij dhe nuk është në proporcion me peshën e veprës penale dhe pasojat e shkaktuara, për çka edhe ka propozuar si më lartë.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit F.R. av. Abit Asllani, pretendon se gjykata e shkallës së parë ka tejkalluar dispozitat në të cilat është thirrur. Ankesa i referohet nenit 38 gjegjësisht qëllimit të

dënimin dhe konsideron se edhe pse gjykata e shkallës së parë ka cituar dispozitën në fjalë, nuk e ka shtjelluar edhe aspektin material të saj. Nga deklarata e palës së dhënë në PPTH të Pejës me dt.02.03.2021, në të cilën thirret edhe gjykata rezulton qartë se i akuzuari është konsumues i narkotikut dhe ka krijuar varësi, ka treguar detaje që kur ka filluar konsumimin motivet, mbrojtja konsideron si të paqartë faktin se të akuzuarit nuk i është kryer një ekspertizë për të dëshmuar varësinë e narkotikut. Mbrojtja do të pajtohet që i akuzuari për një kohë të caktuar edhe të izolohej në institutin shëndetësor, derisa të ishte diagnostifikuar dhe të shërohej nga baza e narkotikut, e cila ka ndikuar që i njëjti të kryej veprime inkriminuese dhe të dëmshme. Mbrojtja thekson se gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave nga nenet 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, ku u referohet në veçanti secilit prej këtyre neneve dhe konsideron se në rastin konkret këto dispozita edhe pse janë cekur nuk janë zbatuar në raport me të akuzuarin. Sipas ankesës, dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është i ashpër dhe në disproporcion me veprën e kryer dhe nuk janë zbatuar standardet ligjore siç parasheh Kushtetuta dhe Konventat Ndërkombëtare. Më tutje mbrojtja konsideron se ka edhe rrethana tjera lehtësuese të cilat nuk janë marrë për bazë, si mosha e re, gjendja shëndetësore e prindërve të akuzuarit. në këtë mënyrë është anashkaluar edhe aspekti i trajtimit ligjor i personave me përgjegjësi të kufizuar dhe se ndaj të akuzuarit është dashur të shqiptohet masa e rehabilitimit shëndetësor dhe mental.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit F.O. av. Gëzim Baloku, pretendon se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendimit mbi dënim ka qenë shumë e ashpër. Sipas ankesës, është dashur të vlerësohen rrethanat lehtësuese si pranimi vullnetar i fajësisë të akuzuarit, bashkëpunimi me gjykatën, mosha relativisht e re, mbajtësi i familjes, rrethana të cilat do të ndikonin në zbutjen e dënimin. Mbrojtja po ashtu thekson se si rrethanë lehtësuese është dashur të merret dëmi jo shumë i lartë i shkaktuar dhe kërkim falja publike e të akuzuarit, si dhe gatishmëria që ta kompensojë të dëmtuarin dhe se nuk ka qenë ideja e të akuzuarit të kryhet vepra penale që është kryer. Lidhur me rrethanat rënduese nuk janë dashur të merren parasysh aktgjykimet e cekura si në arsyetim e për të cilat është arritur rehabilitimi ligjor dhe gjyqësor, prandaj nuk kanë efekt juridik, sepse kur arrihet rehabilitimi personi i dënuar trajtohet sikurse të mos kishte qenë më i parë i dënuar, e jo të merren si rrethana rënduese në ndonjë lëndë të re.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimet e mësipërme ankimore janë të pabazuara për këto arsye:

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimin përkitazi me të akuzuarin F.R. mori pranimin e fajësisë për veprën e kryer dhe kërkim faljen, ndërsa rrethana rënduese mori faktin se ka qenë më parë i dënuar për vepra tjera penale përkatësisht me aktgjykimin PKR.nr.10/20 të dt.09.02.2020, për veprën penale blerja posedimi shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 35 dhe nenin 77 të KPRK-së, po ashtu me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.197/18 të dt.24.05.2018 për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, përkitazi me të akuzuarin F.O. si rrethanë

lehtësuese mori pranimin e fajësisë për veprën e kryer dhe kërkim faljen, ndërsa si rrethana rënduese mori faktin se i akuzuari edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra tjera penale, përkatësisht me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Pejë P.nr.27/09 dhe P.nr.108/09 të dt.23.03.2009, ku i njëjti është dënuar për vepër penale të mashtrimit nga neni 261 par.1 lidhur me nenin 23 të KPRK-së dhe veprën penale të shpërdorimit nga neni 257 par.1 të KPRK-së, si dhe me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë P.nr.235/10 të dt.28.03.2011 është dënuar për vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së, ndërsa për të akuzuarin O.H. si rrethana lehtësuese mori pranimin e fajësisë për veprën e kryer dhe kërkim faljen, ndërsa rrethanë rënduese mori faktin se edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra tjera penale, përkatësisht me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.827/18 të dt.20.07.2020, për vepër penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Vlerësimin e këtyre të rrethanave, si të drejtë e aprovon edhe Gjykata e Apelit, e cila vlerëson se duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, mënyrën se si është zhvilluar ngjarja kritike, kontributin e secilit të akuzuar, rezulton se dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve F.R. dhe F.O. nga gjykata e shkallës së parë janë të drejta dhe të ligjshme, sepse janë në përpjesëtim me peshën e veprës së kryer penale, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve si kryerës dhe janë në shërbim të preventivës së përgjithshme, posaçërisht asaj të posaçme dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 38 të KPRK-së. Për shqiptim të një dënimi më të butë siç propozon mbrojtësi i të akuzuarit, nuk janë plotësuar kushtet ligjore, sepse rrethanat të cilave u referohen ankesat nuk janë të natyrës së tillë që do të arsyetonin dënim më të butë, ndërsa pretendimi lidhur me dënimet e mëparshme-se është arritur rehabilitimi ligjor nuk mbështetet me ndonjë provë konkrete ose fakt në bazë të cilit do të vërtetohej se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 96 të KPRK për rehabilitimin ligjor apo gjyqësor . Po ashtu, rrethanat të cilave u referohet prokurori në ankesë nuk e arsyetojnë shqiptimin e dënimit ma të ashpër. Në fakt, prokurori në ankesë i referohet rrethanave rënduese në vijim:

- shkalla e lartë e pjesëmarrjes së personave të dënuar dhe shkallën e lartë të dashjes me arsyetim se të akuzuarit kanë vepruar si bashkëkryerës, pastaj pozitën e të dëmtuarit i cili ishte në vendin e tij të punës dhe ishte kërcënuar me armë, mirëpo kjo Gjykatë vlerëson se të akuzuarit janë shpallur fajtor dhe janë dënuar si bashkëkryerës, por nuk specifikohet se në çka konsiston shkalla e lartë e dashjes të të dënuarve duke pasur parasysh veprimet konkrete të tyre (rrethanat që ndërlidhen me pozitën dhe rrolin e të akuzuarve në kryerjen e veprës penale). Ndërsa, përdorimi i armës dhe kërcënimin i të dëmtuarit paraqet element cilësues të veprës penale për të cilën ata u shpallën fajtor;

-prezenca e dhunës ose kanosjes më dhunë në kryerjen e veprës penale, si u tha edhe më lartë, paraqet element cilësues të veprës penale, si theksohet edhe në ankesë, andaj nuk e ka cilësinë e rrethanës rënduese;

-ndonjë dënim i mëparshëm, sipas vlerësimit të kësaj gjykatë gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar në masën e duhur si rrethana rënduese me rastin e matjes së dënimit marr parasysh lartësinë e dënimit të shqiptuar të akuzuarve në raport me kufirin e mundshëm ligjor për zbutje të dënimit.

Prandaj, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me rrethanat për matjen e dënimit për secilin të akuzuar veç e veç dhe në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar u referohet dispozitave përkatëse ligjore për zbutjen e dënimit.

Me rastin e shqyrtimit të aktgjykimit të ankimuar, Gjykata e Apelit vëren se gjykata e shkallës së parë të dëmtuarin e ka udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike edhe përkundër faktit se në dispozitiv të aktgjykimit është precizuar lartësia e dëmit-parave që janë marr, mirëpo në mungesë të ankesës nuk u lëshua në vlerësimin e kërkesës pasurore juridike, pasi që lartësia e dëmit të shkaktuar nuk ishte përcaktues për cilësimin juridik të veprës penale për të cilën ata u shpallën fajtor, kurse të dëmtuarit nuk iu shkelen të drejtat e tija meqë u udhëzua në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR 192/2021 datë 14.06.2021

Procesmbajtëse,

Alba Makolli

Anëtarët e kolegjit,

Tonka Berishaj

Bashkim Hyseni

Kryetar i kolegjit,

Burim Ademi
